



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF—NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

**VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES**

**Neni 1
Përbërja**

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarje të subvencioneve për OJQ-të të cilat kanë aplikuar sipas Thirrjes publike për aplikim Nr.1-453-45024 e datës 18.09.2020, në përbërje si vijon:

1. Selman Jashanica, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Albulena Salihu, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
3. Ferdian Shala, nga OJQ-të, anëtar
4. Fidan Tmava, nga shoqëria civile, anëtar
5. Ramiz Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
6. Besart Troshupa, Zyra e Kryetarit të Komunës, anëtar rezerv

**Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit vlerësues**

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarje të subvencioneve për OJQ konform dispozitave të Rregullores MF—NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve

**Neni 3
Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen anëtarët e Komisionit Vlerësues.

1Nr. 453-50288
Lipjan, më 14-10-2020

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

